



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA PUKË
KESHILLI BASHKIAK

Nr. 836/3 prot.

Pukë, më 04.06.2025

VENDIM

Nr. 15 datë 03.06.2025

“PËR
DHËNIEN E TITULLIT “QYTETAR NDERI” I BASHKISË PUKË
Z. AGRON KEÇANI

Në mbështetje të ligjit nr.139/2015 “Për Vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar, neni 9, pika 1.7, neni 54, germa “m”; ligjit nr. 94/2022 “Për Titujt e Nderit dhe Titujt Vendor të Nderit në Republikën e Shqipërisë”, VKM nr.861 datë 10.12.2014 “Për miratimin e rregullave të hollësishme për funksionimin e komisioneve për dhënie medaljeve dhe titujve vendorë të nderit në Republikën e Shqipërisë”, VKB nr.71, datë 27.12.2024 “Për miratimin e rregullores së Komisionit Këshillimor “Për titujt vendor të nderit, kriteret dhe procedurën e dhënies së tyre si dhe emërtimin e rrugëve, shesheve, territoreve, institucioneve dhe objekteve në juridiksionin e Bashkisë Pukë”, me propozim të kryetarit të Bashkisë Pukë, si dhe pas miratimit të Komisionit Këshillimor për Medaljet dhe Titujve Vendor të Nderit në Bashkinë Pukë, Këshilli i Bashkisë Pukë, në mbledhjen e tij me datë 03.06.2025;

VENDOSI:

1. T’i akordojë titullin “QYTETAR NDERI” i Bashkisë Pukë.

Z. AGRON KEÇANI

Me motivacionin:

“Për rolin e tij në afirmimin e vlerave më të mira të komunitetit shqiptar në Itali, sipërmarrës i suksesshëm dhe një nga kontribuutorët e binjakëzimit të Bashkisë Pukë me Komunën e Signas, humanist dhe vizionar i përkushtuar në dobi të vendlindjes”.

2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë!
3. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohen: Këshilli i Bashkisë, Kryetari i Bashkisë dhe Drejtoria e menaxhimit të burimeve njerëzore.
4. Vendimi u shpall me datë 03.06.2025.
Vota të vlefshme gjithsej 8
Vota pro 8 vota kunder 0 , vota abstenim 0

SEKRETARI

Hazbi Terbuni

KRYETARI

Gjon GJOKA

